

Gjashtëmbëdhjetë ditë të aktivizmit

“Kur bashkëshorti im dehej, ai më rrihte vazhdimisht duke më goditur me çfarëdo që i binte në duar. Ky zakon u kthye në përditshmëri,”

‘Teuta’ një viktimë e dhunës familjare

“Unë linda vajzë. Në vend se të gëzohesha, u ndjeva shumë e pikëlluar. Ndoshta vajza ime do të kishte fat të njejtë,”

‘Fatimja’, një viktimë tjetër

Nga Edita Buçaj



Çdo së tretës grua në botë mund t'i shken të drejtat vetëm pse ajo është femër. UNIFEM-i dhe Fondi Zhvillimor për Femra i Kombeve të Bashkuara filluan një fushatë të përqëndruar në dhunën ndaj femrave për të tërhequr vëmendjen në këto të dhëna tragjike të bazuara në hulumtimet ndërkombëtare. Një në tri - kjo shifer marramendëse përmbledh krizën me të cilën ballafaqohen femrat në mbarë botën: çdo e treta grua mund të dhunohej, rrahet, të detyrohet në seks ose të keqpërdoret në mënyra të ndryshme gjatë jetës së saj.

Fatkeqësisht, Kosova nuk është e izoluar nga kjo dukuri globale. Dy citimet më poshtë janë marrë nga dëshmitë e dy grave, viktimat të dhunës familjare në Kosovë. Këta dy shembuj tregojnë qartë se dhuna ndaj femrës është edhe këtu një dukuri e përhapur.

Në të njëjtën kohë, Kosova iu bashkua një lëvizjeje ndërkombëtare për të luftuar dhunën kundër femrës, këtë vit nën parullën, ‘Reago! Dhuna është krim’. Kjo ishte tema kryesore e fushatës së Misionit të OSBE-së në Kosovë, e cila kishte filluar me 25 nëntor në Ditën Ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj femrave dhe ka përfunduar me 10 dhjetor, që është dita ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

‘Familja është institucioni më i fuqishëm në Kosovë, por dhuna në familje ekziston ende për shkak të mungesës së institucioneve tjera të fuqishme shoqërore. Puna jonë është ngritja e vetëdijes për këtë problem dhe inkurajimi i meshkujve dhe femrave që të luftojnë kundër kësaj dukurie,’ tha Ambasadori i Misionit të OSBE-së Paskal Fieski, në hapjen e kësaj fushate.

Duke u nisur nga kjo, ngjarje të ndryshme janë mbajtur anëmbanë Kosovës për ta diskutuar dhe debatuar këtë çështje, si dhe për të përkrahur shërimin dhe pranimin e femrave të cilat janë viktimat të dhunës. Trajnime dhe seminare të ndryshme janë organizuar me qëllim të edukimit të të rinjve dhe studentëve, por edhe të profesionistëve siç janë mësuesit dhe policia për t’iu bërë atyre të mundur t’iu përgjigjen viktimave dhe autorëve të dhunës ndaj femrave.

Trajnuesit nga zyra e OSBE -së për Mbrojtje dhe Përkrahje të Viktimave ishin shpërndarë nëpër tërë Kosovën, duke përcjellë porosinë se dhuna ndaj femrave është e papranshme në çfarëdo konteksti. Ata gjithashtu ekzaminuan lloje të ndryshme të krimeve të dhunës ndaj femrave: dhunën familjare, e cila mund të marrë formën e keqtrajtit

fizik, incestin ose turpërimin personal, dhe dhunën ndaj femrave që shkaktohet jashtë shtëpisë, si rasti te dhunimi apo trafikimi për prostitucion.

Fushata e udhëhequr nga OSBE-ja është vazhdimësi e përpjekjeve të rëndësishme të mëparshme të organizatës për të përpiluar dhe siguruar miratimin e rregullores mbi ‘Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje’ gjatë këtij viti. Ky dokument i rëndësishëm ligjor kodifikon ndalimin e dhunës ndaj femrave dhe gjithashtu vendosë standarde të reja mbi mundësitë e autoriteteve për të mbrojtur viktimat. P.sh. rregulloria u lejon gjyqeve të Kosovës të nxjerrin rregulla mbrojtëse për viktimat, duke e bërë atë një vepër penale për autorin e krimit edhe në rast të afrimit shtëpisë apo vendit të punës së viktimës.

OJQ-të bashkëpunuese dhe mediat vendore kanë dhënë kontribut të madh në fushatën e këtij viti në tërë Kosovën. Përpjekjet përshijnë emisionet e drejtëpërdrejta dhe shpalljet në radio, reklamata televizive, pllakatat e mëdha, posterët dhe fanellat. Përveç këtyre, fjongo të bardha iu shpërndanë meshkujve me role udhëheqëse që t’i bartin si një simbol i zotimit të tyre se kurrë nuk do të bëjnë, harrojnë ose heshtin dhunën ndaj femrave.

VIKTIMA E DHUNËS NË FAMILJE FLET HAPTAS

“Më dukej se dëgjoja vajzën duke qarë, por nuk mund të kthehesha”

‘Fatimja’ i kishte vetëm pesëmbëdhjetë vjetë kur u martua me njeriun që nuk e kishte parë kurrë më parë. Burri i saj jetonte në një familje të madhe. Shpejtë e kuptoi se jeta me të do të ishte e vështirë. “E kisha vështirë ta doja” thotë ajo. Që në ditët e para të martesës ajo e kuptoi se me çfarë njeriu kishte të bënte. “Ishim të ftuar në një dasmë. Në mbrëmje ai veshi rrobata festive dhe ra me fjetë me to. Kjo gjë më pengoi sepse nuk m’u duk gjest normal. Ai vazhdonte ashtu dhe kjo u bë përditshmëri”, thotë ajo. Kur ajo ia tërhoqi vërejtjen atëherë filloi shamata. “Unë nuk guxoja as t’i tregojë njeriu se çfarë ndodhte. Çdo ditë që kalonte ma bënte

jetën më të vështirë. Unë nuk desha të bëjë fëmijë me të, ai më tepër më jepte dajak se bukë. Gjatë dy viteve të para të martesës një motër medicinale e cila ishte mike e shtëpisë më siguronte hapa kontrceptiv, por më vonë kur ajo u transferua në një vend tjetër dhe unë mbeta shtatzënë. Këtu filluan edhe vuajtjet e mia të padrueshme”.

‘Fatimja’ pohon se izolimi për të ishte po gati aq i vështirë sa edhe vet dhuna.

“Ata ma ndaluan të dal , të shkojë te familja ime, të flas lirshëm, ma ndaluan çdo gjë. Filluan të më përcjellin në çdo hap. Kjo ishte më e rëndë se

dhuna fizike. Vajzën e linda në shtëpi. Nuk më dërguan në spital, pr arësye se kishin frikë se zbuloja dhunën që përjetoja . Edhpe isha shtatzënë burri prap vazhdonte të më rrahe. Si pasojë e rrahjeve kisha dhimbje të madhe në nyje të duarëve dhe këmbëve. Kur më kaploi dhimbja e madhe ata më dërguan në ambulancë. Një motër medicinale që punonte aty vërejtë shenjat e rrahjes dhe aty për herë të parë tregova për dhunën që ushtronte burri ndaj meje. Ajo më premtoi se do të më ndihmonte. E linda vajzën dhe në vend se të gëzohesha u mërzita shumë, mbase edhe kjo kur të rritet do të pësojë njësoj si unë.”

Më në fund ‘Fatimja’ nuk mund të durojë më.

“Kur vajza ime po i afrohej ditëlindjes së parë unë u detyrova të iku, përdryshe do të paralizohesha. Përdërisa vrapoja nëpër pyll më bëhej sikur ndëgjoja vajin e vajzës. Kisha dhimbje për të, por unë gati po shkatërroheshja, edhe pak ditë dhe unë nuk do t’i shërbeja as vajzës sime.”

Fatimja më vonë kërkoi strehim në shtëpinë e sigurte. Ky artikull bazohet në dëshminë e sajë të dhënë punëtorëve social në strehimore. Emri i saj është ndryshuar dhe emri i qytetit të sajë nuk tregohet për shkaqe të njohura.

NË KËTË NUMËR

Më dukej se dëgjoja vajzën duke qarë, por nuk mund të kthehesha

faqe 2

Trafikimi si një praktikë neveritëse

faqe 3

Një dritare e hapur drejt botës

faqe 6



**Ambasadori
Paskal Fieski**
shëf i misionit të OSBE-së në Kosovë

Misioni i OSBE-së në Kosovë së bashku me ju është duke përfunduar një vit të suksesshëm. Ishte një vit përplotë me sfida dhe besoj se ia dolëm t'i tejkalojmë shumicën prej tyre.

Brenda kornizës për implementimit e 'Standardeve për Kosovën', ne do të vazhdojmë punën tonë së bashku me të gjithë njerëzit dhe institucionet e Kosovës për përforcimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit.

Vitin që po e lëmë pas ishte i shënjuar me ngjarje të ndryshme, të gjitha të rëndësishme për Kosovën, por për një moment dua të qëndrojë jashtë politikës dhe të theksojë një çështje të veçantë - të drejtat

e njeriut, e cila është baza e shoqërisë së sigurtë dhe të qëndrueshme.

Të drejtat e njeriut janë në rend të parë në mendje dhe sjellje të njerëzëve, gjithashtu edhe në institucione.

Kështuqë, më heret gjatë këtij viti, Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe shtylla e I-rë e UNMIK-ut kanë nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit, për theelimin e objekteve të përkohshme për siguri ose shtëpitë të sigurta për femrat e abuzara ose viktimat e trafikimit.

Njësa jonë për avokim dhe mbrojtje të miktimitave ka dhënë kontributin maksimal në hartimin e rregullorës për 'Mbro-

tjen kundër Dhunës në Familje' nr. 2003/12, e miratuar këtë vit më 9 maj.

Ne kemi kontribuar në ligjin kundër diskriminimit, i cili është studjuar nga Kuvendi për herë të parë. Gjithashtu projekt ligji për barazi gjinore është në rrugë e sipër. Së bashku me shumë bashkëpunëtorë, ne kemi organizuar Konferencën për luftimin e trafikimit me qenje njerëzore në Kosovë.

Procesi i përpilimit të planit të veprimit, si një rezultat i kësaj konference, është duke lëvizë përpara me rekomandimet tona të cilat do të nxjerren së shpejti.

Ne kemi pasur një fushatë kundër dhunës ndaj femrave, për

të ngritur vetëdijen për këtë dukuri dhe për të ndihmuar institucionet vendore për ta luftuar këtë atë.

Shumë meshkujë kanë vënë 'Fjongon e Bardhë' për të treguar zotimin e tyre ndaj fushatës, dhe shpresoj se ata edhe do të mbajnë premtimin e dhënë.

Unë dua të përfundojë këtë pjesë duke përmendur përsëri atë që thashë kur filluam fushatën: familja është institucion i shenjtë me femrën si shtyllë e sajë.

Të gjitha familjeve në Kosovë ju uroj Gëzuar Viti i Ri me shpresë se viti i ardhshëm do të jetë i suksesshëm, i qetë, dhe më i mirë për të gjithë.

VIKTIMA E DHUNËS NË FAMILJE FLET HAPTAS

"Më parë do të flija në qeli se sa në atë shtëpi"

Le ta quajmë 'Teuta'. Ajo u lind në vitin 1970 si fëmija i parë nga katër të tjerë në familje. Edhe pse u martua pa dëshirën e saj, ajo qonte jetë normale gjatë vitit të parë të martesës, por kjo nuk zgjati shumë. Maltretimet e para filluan pas një viti e gjysmë kur ajo mbeti shtatzënë.

"Kur burri im pinte, më rrahte pandërprerë me çfarë i kapte dora. Kjo filloi të bëhet përditshmëri. Kur ai më linte të qetë, vazhdonin vjehrritë dhe kunatat. Nga 70 kilogram që kisha kur u martova, rash në 45 kg. Duroja për shumë arsye: isha shtatzënë, babain e kisha të sëmurë dhe nuk doja ta shqetësoja, më pengonte edhe ajo se çfarë do fliste rrethi ku jetoja dhe në fund të fundit nuk besoja se dikush ishte në gjendje të më ndihmonte.

Ditët kalonin dhe dhuna ndaj meje shtoej çdo ditë, bile edhe pas lindjes së djalit."

Burri nuk rrahte vetëm gruan. "Djalin nuk e donte aspak. Filloi ta rrahte që kur ishte si foshnje, duke më akuzuar mua se djali nuk ishte i tij. Njëherë e dërgoi atë në shtallë dhe e rrahu keq. Djali u sëmurë dhe kishte temperaturë të lartë. Unë nuk guxoja të ndërhyja. Sikur edhe vetëm një fjalë ta nxirrja nga goja atëherë vjehrritë do të më vërsuleshin."

Tezja e Teutës e mbështeste atë dhe e këshilloi t'i tregonte babait për të gjitha, por nuk donte ta trazonte për shkak të se ai qëndronte keq me shëndet. Ndërkohë burri i sajë shkante me një vajzë tjetër. Pasiqë situata çdo ditë e më tepër vinte

duke u keqësuar, ajo vendosi të raportojë në polici.

"Një ditë pas një rrahje të fortë nga burri vendosa të raportojë në polici. U zgjova në ora katër të mëngjesit mora djalin dhe ika. Mirëpo në rrugë e takova një polic i cili më njihte dhe ai e lajmroi vjehrrin. Vjehrrin më zuri rrugës dhe më rrahu aq shumë sa nuk kisha forcë të ngritem."

Teuta nuk u dorëzua. Ajo e luti tezen e vet që t'i tregojë babait dhe policisë se çfarë po i ndodhte.

"Pas tri dite policia erdhi disa herë në shtëpi dhe i pyeste ata pse më rrihinin, por ata përgjigjeshin se askush nuk më prek. Herën e fundit kur erdhën iu thash se më parë do të flija në qeli se sa në atë shtëpi, por prej djalit nuk mund të ndahesha.

Pastaj policia më ndihmoi dhe më dërguan në kishën katolike në Pejë. Një ditë përderisa isha duke shkuar në qendrën për punë sociale për të biseduar për problemin që kisha, takova burrin tim i cili kishte qenë duke më kërkuar. Ma rëmbeu djalin nga duart, mua më shtyri dhe më përplasi në baltë në mes të rrugës. Njerëzit në shikonin me neveri, çka më bëri të ndihem shumë keq. Mezi u ngrita dhe arrita të shkojë në polici. Më vonë ata ia dolën të ma kthenin djalin."

Më vonë Teuta kërkoi strehim në shtëpinë e sigurtë. Këto janë fjalët e saj, që ajo ua ka thënë punëtorëve social në strehimore. Emri dhe qyteti i sajë mbahen në mbrojtje të personalitetit të saj.

Shpend DHJETORI



DEAE
DEALS
DEALI

Pruga Beograd 32 38000 Pristina
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188
E-mail: press@omik.org

Botuesi:
Sven Lindholm
Kryeredaktore:
Arni Snaevarr

Redaktore:
Hasan Sopa (Detaje)
Slavica Mladenović (Detalji)
Diserji & faqësja
Shpend Kada

Bashkëpunëtorë:
Srdjan Antij, Edita Burcaj,
Xhef Bili, Chris Cycmanick,
Afrone Citaku, Mustafa Eric,
Arben Hajredinaj, Xheme Ibraj,
Rexhep Krasniqi, Fatime Lepaja,
Nderim Pasuli, Gezim Rexha,
Halide Sadiku, Olivera Stojanovic,
Mevlyde Saliu, Mustafa Skenderi,
Slavica Staletoviq, Besnik Tahiri,
Armed Tahirsylaj, Irfan Ukshini,
Bernard Urban

osce
Mission in Kosovo

Shënim:
Pikëpamjet e paraqitura apo prezantimi i materialeve të botuara nuk shprehin politikën, opinionin apo qëndrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë.

Trafikimi si një praktikë neveritëse

OSBE-ja shton aktivitetet e trajnimit kur Kosova po hyn në një periudhë me dukuri tmerruese të trafikimit me qenjë njerëzore.

Nga Hana Kranston

“Trafikimi i fëmijëve është një prej praktikave më neveritëse dhe më të tmerrshme që njihet ndonjëherë. Kështu deklaroi njëri nga përfaqësuesit e minoriteteve nga qendra për punë sociale në Mitrovicë, duke reaguar ndaj formës së trafikimit me njerëz në Kosovë. “Dënimit me burg duhet të jenë shumë më të larta për trafikantët me fëmijë, pasi që këto dënime do të ndikojnë në vepërimit e të tjerëve,” tha Lubisha Kostiq.

Ky mendim është një pasqyrë e pakënaqësisë në mbarë Kosovën dhe shqetësimi për dukurin e trafikimit me njerëz, që është në rritje. Seksioni për të drejtat e njeriut dhe mbrojtje dhe avokim të viktimave ka organizuar një numër sesionesh trajnimit për anëtarët e institucioneve të Kosovës dhe OJQ-të, për ngritje të vetëdijes, identifikim të aspekteve të ndryshme dhe shqyrtim të legjislacionit që kanë të bëjnë me trafikimin.

Një trajnim i tillë është mbajtur më 26 dhe 27 nëntor në bashkëpunim me ministrinë e punës dhe mirëqenjes sociale, në Mitrovicë. Kanë marrë pjesë dymbëdhjetë pjesëmarrës nga qendrat rajonale për punë sociale, njësia për trafikim dhe prostitucion e UNMIK-ut dhe OJQ-të rajonale.

Tre trajner, Alma Begicëviq, zyrtare për të drejtat e njeriut nga OSBE-ja, Ariana Qosaj-Mustafa, këshilltare ligjore për të drejtat e grave dhe fëmijëve nga OSBE-ja, dhe Selvetë Gërxhaliu, konsultante për shkeljen e çështjes gjinore në Ministrinë e punës dhe mirëqenjes sociale të asistuar nga OSBE-ja.

Kontrabanda ose trafikimi

Çështjet e përfshira në trajnim ishin sqarimet rreth dallimit në mes të kontrabandës dhe trafikimit. Është përmendur se ekziston një vijë shumë e hollë në mes të dy dukurive, por madje edhe nëse personi pajtohet që të kalojë kufirin me qëllim që të punojë pa dokumente të duhura, ato mund të rrezikohen më vonë me rrëmbim dhe përdorim të forcës. Posa kontrabandisti të transferoj një person prej një shteti në shtetin tjetër, ata mund të përdorin pozitën e tyre si mundësi për të eksploatuar punën personave, ose t'i shes ata të trafikantët.

Personat të cilët kanë qenë të kontrabanduar në mënyrë ilegale përtej kufirit tashmë janë në situatë të pafavorshme, pasi që ata me vetëdije kanë bërë kundërvajtje - siç është udhëtimi me dokumente të falsifikuara dhe hyrje ilegale. Nëse ata e gjejnë veten në një situatë



Pjesëmarrës në seminarin për trafikim me qenjë njerëzore në Mitrovicë

ku mund të trafikohen, ata janë në një pozitë të dobët të pazarlëku. Është vetëm një mësim për të mësuar prej kësaj: mos udhëtoni ilegalisht ose mos lejoni personin tjetër të sigurojë dokumente për ju.

Deklaratë Univerzale

Grupi që morri pjesë në trajnim gjithashtu ka analizuar ‘Deklaratën Univerzale për të Drejtat e Njeriut’, për të ekzaminuar se cilat nene ligjore do të ishin shkelur në raste të trafikimit. Konkluzioni ishte se gati të gjithë u pajtuan se trafikimi është një nga abuzimet më të rënda të të drejtave të njeriut dhe për këtë arsye denimi duhet të duhet të jetë i lartë. Neni 4 i Deklaratës është në veçanti i plotëfuqishëm në raport me trafikimin.

“Askush nuk duhet të mbahet në skllavëri ose robëri; skllavëria dhe tregtia me skllavë duhet të ndalohet në të gjitha format.”

Pozita e femrave të ekzaminohet dhe shqyrtohet

Prania e trafikimit në Kosovë dhe rajonet për rreth konfirmim ekzistimin e skllavërisë në Evropë; një praktikë arkaike dhe brutale që është bërë në mënyrë ilegale në vitet 1800. Qeveritë duhet të vijnë zero tolerancë për qasje në trafikim.

Të definuarit e aspekteve të ndryshme të trafikimit dhe të involvuarit e marrëveshjes për çështjen e të drejtave të njeriut duket se është një pjesë e lehtë për këtë trajnim, por vetëm ligjshmëria nuk do të frenojë rritjen e trafikimit në Kosovë. Në mënyrë që plotësisht të preket problemi i trafikimit, pozita e femrës në shoqëri duhet të ekzaminohet dhe

shqyrtohet. Tradicionalizmi është i pranueshëm dhe nganjëherë shumë i dëshirueshëm mbrenda kulturave, por jo kur ka ndikim në të drejtat dhe pozitën sociale të një pjesë të qytetarëve siç është femra. Mjerisht, njollimi mbrenda strukturave shoqërore dhe shtetërore në Kosovë vazhdon të bëhet edhe më tutje ndaj femrave të cilat janë viktimat të dhunës, e kryer nga meshkujt. Femrat të cilat janë viktimat të dhunës nganjëherë durojnë njollën e humbjes së nderit që ka të bëjë me rastin e tyre.

Dhunimi mund të shfrytëzohet për të rrezikuar dhe kompromentuar identitetin e femrës - siç është rasti i dhunimeve gjatë luftës. Kur gjatë procesit të trafikimit përdhuhet seksualiteti i femrës, femra ka nevojë për ndihmë sepse është bërë një fyerje personale ndaj saj. Femra nuk duhet të fajësohet për shkak se ka qenë pjesë e dhunimit, sepse në këtë rast nuk është sulmuar nderi kolektiv i familjes ose komunitetit. Nuk është turp për viktimën por për kriminelin i cili mashtron ose kidnapon një person për ta bërë skllav.

Nëse viktimat ndihen të turpëruara për atë që i'u ka ndodhë, atëherë ato nuk do të flasin se çfarë kanë përjetuar. Nëse kryesit e kriminit nuk identifikohen ndonjëherë, ata kurrë nuk do të sillen para drejtësisë dhe problemi do të vazhdojë të rritet.

Si të ndihmohen viktimat

Pjesëmarrësit e trajnimit janë këshilluar se duhet të bëhet një ndryshim i qasjes mbrenda komuniteteve. Kur ‘këshilli i të mosuarëve’ ose ndonjë subjekt ekuivalent thirret për të shqyrtuar gjendjen e viktimës së

koncepti i pastërtisë seksuale për të krijuar standardet e barabarta për femra dhe meshkuj. Nëse femra është vlerësuar si e barabartë në shoqëri me meshkuj, veprimi i tyre nuk duhet të shqyrtohet si jo i drejtë kur merret parasysh dhunimi ose rrëmbimi i tyre.

Si të ballafaqohemi me fajësimin kultural

Gjithashtu, ekziston një kulturë e fajësimit dhe diferencimit që ka të bëjë me kryesin e vepërës dhe rastet. Një prej pjesëmarrësëve të trajnimit për trafikim në Mitrovicë u mundua të bëjë dallimin në mes të trafikimit të fëmijëve dhe trafikimit të femrave, në lidhje me dënimet që duhet të miratohen për kriminelët e dënuar. Ndërsa kushtet dhe rëndësia e trafikimit me fëmijë është çështje më e komplikuar, për këtë arsye rezultati dhe krimi aspak nuk dallojnë prej trafikimit me femra.

Ndryshimi i ideve themelore në shoqëri të Kosovës ka treguar se trafikimi është rritur dhe është bërë më i dukshëm. Me lirinë e mediave edhe informimit mbulohehen më shumë çështjet siç është edhe trafikimi: Kosova tash ka një përparësi pasi që është në gjendje të mësojë më shumë për raste të trafikimit dhe kështuqë të reagojë ndaj këtij krimi në mënyrë aktive me një opinion të informuar.

Trajnimiti ka mundësuar koordinim më të mirë në mes organeve që ofrojnë shërbime dhe mbrojtje për viktimat e trafikimit. Është jetësore që institucionet prëgjegjëse që kanë autoritet për t'u marrë me këto çështje kanë resurse dhe njohuri të cilat mund t'i shfrytëzojnë për të kryer punët e tyre.



Alma Begicëviq, zyrtare për të drejtat e njeriut në zyrën e OSBE-së në Prizren, trajnuesëve në seminarin për trafikimin me njerëz

Trafikimi pengesë serioze sociale

Sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM), prej 700.000 deri në 2.000.000 femra janë viktime të trafikimit në vit.

Nga Nderim Pasuli



Pjesëmarrësit ndëgjojnë rrëfimin e viktimës, mënyrën se si ajo është trafikuar

Shenjat e keqpërdorimit, turimit, vuajtjes nga uria e në disa raste edhe prangimi i viktimave janë mëse evidente. Reakcionet e viktimave përcillen me frigë dhe emocione, të cilat mund t'i paralizojnë ato. Reagimi traumatik dhe hutia paraqiten kur rezistimi i viktimave ndërpritet dhe vetëmbrojtja njerëzore dobësohet dhe çorjentohet. Në këto raste kër-

kohet një çasje adekuate dhe komplekse e specialistëve dhe punëtorëve sojal. Në të njëjtën kohë, është mëse e nevojshme mbështetja familjare por edhe e komunitetit.

Më 9 Dhjetor 2003, zyra e OSBE-së në Prizren, në bashkëpunim me zyrën komunale për çështje gjinore organizoi një takim rajonal kundër trafikimit. Mbledhja është mbajtur

në kuvendin komunal të Prizrenit, si pjesë e fushatës dy-javore për vetëdijësimin e opinionit publik me problemin e dhunës ndaj femrave, të udhëhequr nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Kjo ngjarje i bashkoi përfaqësuesit të organizatave të ndryshme si OSBE-në, IOM-in, njësitin special policor për hulumtimin e rasteve të trafikimit dhe të prostitucionit, de-

partamentin e drejtësisë, zyrën për punësim dhe mirëqenie sociale, zyrën komunale për çështje gjinore, si dhe zyrën komunale të inspektionit dhe të prokurorisë. Më tepër se 50 pjesëmarrës janë njoftuar për masat konkrete që janë duke u ndërmarrë kundër trafikimit nga autoritetet pëkatëse për parandalimin e këtij fenomeni të shëmtuar.

"Jemi mbledhur këtu që mundësisht t'i identifikojmë problemet e trafikimit në rajonin e prizrenit dhe t'i koordinojmë hapat e mëturshëm. Ky është një rast për secilin për të kuptuar dhe për të pasur një botëkuptim më të qartë në lidhje me këtë fenomen dhe për ta luftuar trafikimin në mënyrë më efektive", tha Alma Begiceviq, zyrtare e lartë për të drejtat e njeriut nga zyra e OSBE-së në Prizren.

Të pranishmit diskutuan në mënyrë aktive shumë probleme të paraqitura gjatë luftimit të trafikimit dhe prostitucionit të dhunshëm. Znj. Adelina Sopi, zyrtare komunale për çështje gjinore, ishte njëra nga folësit e parë që iu drejtua pjesëmarrësve. "Zyra jonë ka implementuar me sukses fushatën "Ndal Trafikimit", ku ideja ishte ve-

tëdijësimi i rinisë për pasojat negative të trafikimit ndaj shoqërisë. Ne jemi të përqëndruar në organizimin e aktiviteteve të tilla edhe në të ardhmen", tha në vazhdim Znj. Sopi.

Në këto mbledhje rajonale, ishte prezent edhe Zonjusha Diana Tudoraqe, nga IOM-i dhe ky ishte një rast i mirë për të gjithë pjesëmarrësit që të mësojnë më tepër për efektet traumatike të trafikimit dhe për pasojat negative të këtij krimi në shoqëri.

Sipas pjesëmarrësve, viktimat e trafikuar ende njolosen në Kosovë. "Kthimi i identitetit të viktimave të traumatizuara është vendimtar dhe kritik për shërimin e tyre. Derisa prindërit në të shumtën e rasteve janë kooperativ, komuniteti në përgjithësi duhet të bëjë më shumë për riintegrimin e këtyre viktimave në shoqëri", tha Znj. Tudoraqe.

Gjatë mbledhjes u bë e qartë se secila organizatë e përfaqësuar është duke punuar në mënyrë të pavarur sipas mundësive dhe kapaciteteve të veta. Mirëpo në fund pjesëmarrësit pranuan se është e nevojshme një qasje më sistematike dhe koordinim më i madh në mënyrë që lufta kundër trafikimit të jetë më efektive.

Dhuna familjare në fokus

Nga Elisabet Kampestrini

Dy organizata kryesore jo-qeveritare nga rajoni i Gjilanit kanë organizuar dy debate publike të ndara me rastin e fillimit të fushatës mbi dhunën në familje. Debatit i parë është mbajtur me 29 nëntor në Kamenicë dhe i dyti me 1 dhjetor të vitit 2003 në hotelin Kristal në Gjilan. Qëllimi i këtyre dy debateve ka qenë të angazhohet në këtë proces të ngritjes së vetëdijës femra aktive të të gjitha profesioneve dhe përfaqësuesve të OIQ-ve të ndryshme.

Folësit kanë udhëhequr diskutimet duke e prezentuar punën e tyre në luftimin e dhunës ndaj femrave. Femra të të gjitha për-

katësive etnike kanë qenë pjesëmarrëse në të dy debatet. Të stimuluar nga folëse shumë aktive, të dy debatet kanë qar në diskutime të gjalla në mes të folëseve dhe mysafireve.

Debatit publik në Kamenicë është organizuar nga OIQ-ja serbe 'Kosovska Devojka'. Një grup shumëetnik prej më shumë se 30 femrave ka diskutuar mbi ndikimin e dhunës në familje në jetën e përditshme të femrave të rajonit dhe ka sugjeruar hapa të rëndësishëm që duhet të ndërmerren. "Diskutimet më interesante u shfaqën gjatë një ushqimi të shijshëm, të përgaditur nga organizatori - OIQ-ja 'Kosovska

Devojka'. Ishte diskutim shumë jozyrtar por me gjithëate ishte atmosferë e bujshme, e cila ndikoi shumë që gratë prezente t'i shfaqin mendimet dhe brenat e tyre individuale." tha përfaqësuesja e OSBE-së Sadete Tërnavo-Osmani.

Debatit në Gjilan është organizuar nga OIQ-ja 'Liria'. Të gjitha pjesëmarrëset e ftuara ishin femra aktive profesionale si p.sh. mësuese, mjekë, zyrtare komunale dhe përfaqësuesve të OIQ-ve vendore. Një aktore pasqyroi dhimbjet e një gruaje të dëmtuar dhe aktroi në mënyrë mbresëlënëse tregimin e një viktime të tillë, vajzat e së cilës ishin detyruar të ushtronin prostitucionin nga babai i tyre i dhunshëm.

Pjesa kryesore e debatit ishte përqëndruar në informimin e publikut për Qendrën e Grave të quajtur 'HOPE' (SHPRESA) në Gjilan, e cila është në themelimin e sipër. SHPRESA do të jetë në dispozicion për femra dhe fëmijë për këshillim psikosocial, ndihmë ligjore, kuadro trajnuese dhe aktivitete rekreative për femrat e të gjitha moshave dhe përkatësive etnike. Kjo qendër do të jetë edhe shtëpi e sigurtë (strehimore) për përkrrahje

urgjente të viktimave të dhunës në familje duke ofruar ndihmë 24 orë në ditë dhe përkrrahje për gratë dhe fëmijët që vuajnë nga mardhënje abuzive. Qendra financohet nga qeveria austriake, kuvendi komunal i Gjilanit dhe OSBE-ja.

Disa përfaqësuesve të OIQ-ve kanë ndarë përvojat e tyre me femra të cilat kanë nevojë për ndihmë por i'u mungon guximi të bëjnë publike brenat e tyre nga frika e hakmarrjes nga familjet e tyre. Në këtë kontekst, kordinatorja e qendrës së grave në Gjilan theksoi se shpeshherë përçarja në familje është më e

madhe pas kthimit në shtëpi të viktimave, të cilat kanë qenë të strehuara për një kohë të shkurtër. Sidoqoftë, ajo nënvizoi rëndësinë dhe domosdoshmërinë e punës në strehimore pasi që viktimat të paktën lirohen nga situatat e dhunshme të momentit. Ajo inkurajoi strukturat zyrtare në nivelin lokal dhe ato qëndror që në të ardhmen të marrin në konsiderim strehimin social për këto femra.

Në fund, pjesëmarrëset e të dy takimeve u zotuan për vazhdimin e punës së tyre për të ndihmuar viktimat e dhunës në familje.



Femrat nga OIQ-ja 'Liria' në Gjilan, duke diskutuar për dhunën në familje



Femrat nga OIQ-ja 'Kosovska Devojka' në Gjilan duke diskutuar për dhunën në familje

Edukimi i të rinjëve për demokraci

“Toleranca është vendim personal i cili rrjedh nga besimi që secili person është një thesar. Unë besoj se ndryshueshmëria është forcë. Gjithashtu e kam të qartë se injorimi, mosnjohësia dhe besimi i verbër mund ta kthejnë ndryshueshmërinë në burim të paragjyqimeve dhe diskriminimit. Të ndihmojmë në ruajtjen e ndryshueshmërisë si burim të fuqisë dhe të krijojmë një ambient më të mirë për të gjithë.” - Deklarata e miratuar mbi tolerancën, ishte nxjerje nga revista Tema, revistë e Shoqatës së Sociologëve dhe Filozofëve të Kosovës.

Nga Salih Elshani

Gjysma e fundit të shekullit të kaluar ka qenë një periudhë e errët për historinë Kosovare. Si pasojë e dominimit të partisë Komuniste dhe pastaj vitet e konfliktit pas rënjes së saj, njerëzit e posaqërisht të rinjtë nuk patën rast të shijojn vlerat e vërteta të demokracisë. Përveq kësaj, ekzistonte një mungesë edukimi politik jo vetëm në mesin e të rinjëve por edhe të disa anëtarëve të moshuar të partive politike, që krijojnë një atmosferë të urrejtjes dhe mostolerancës. Shumica e anëtarëve të partive politike konsiderojn kundërshtarët e tyre politik jo si garues të tyre por si armiq më të përbeutur. Kjo poashtu pati një ndikim në sjelljet e të rinjëve të Kosovës.

Shumica e popullatës së Kosovës ka një moshë relativisht të re. ‘Edukimi i të Rinjëve për Demokraci’ një projekt i cili ishte implementuar në Komunën e Suharekës gjatë muajit Qershor 2003, ka tentuar t’iu ofroj atyre një trajnim themelor në lidhje me këto çështje. Gjatë gjashtë ditëve të këtij trajnimit intensiu u trajtuan temat siq

janë zgjedhja paqësore e konfliktit, toleranca, institucionet demokratike, paqja dhe të drejtat e njeriut.

Ishte impresive të dëgjosh se si të rinjtë përceptonin dhe paraqitnin pikëpamjet e tyre për demokracinë dhe vizionet e tyre për të ardhmën. Krijimi i besimit në mes të grupeve të ndryshme etnike, religjioze, politike dhe gjinore, filozofia që të gjitha konfliktet pa marrë parasysh se të çfarë lloji janë, mund të zgjidhen me anë të mjeteve paqësore, ishte një nga qëllimet e këtij projekti. Përmes këtij seminary nxënësve patën rast të marrin një edukim që do të mund të përdoret dhe zbatohet më tutje në familjet e tyre, me të afërmit dhe shokët e tyre dhe në jetën e tyre të përditshme.

Çështja e tolerancës aq shumë e diskutuar dhe si një parakusht për përpunimin e shoqërisë kosovare, duket të jetë trajtuar si tema kryesore gjatë këtij seminary, i cili në përfundim inicoi miratimin e deklaratës mbi tolerancën.



Të rinjtë nga trajnimi për demokraci në Suharekë

Diskriminimi nuk është opcion

Është me rëndësi shumë të madhe që komunitetet ta marrin rolin udhëheqës për promovimin e çështjeve gjinore

Nga: Kreshnik Basha



Femrat nga komuniteti turk dhe boshnjak gjatë një seminary në Prizren diskutojnë për barazinë gjinore

Çështja e diskriminimit ka qenë njëra ndër temat e diskutuara në shumë punëtori nga seminarat e organizuara nga organizatat e shumta kombëtare dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Shumë ide dhe eks-

periencia janë shkëmbyer me qëllim të gjetjes së një çasje më të përshtatshme ndaj këtij fenomeni. Shumë forma të diskriminimit ndaj femrave janë edhe sot një ndër problemet që ekzistojnë në këtë fushë dhe që

është e nevojme të adresohen në mënyrë konstante.

Shkakëtarët kryesor të diskriminimit

Në Tetor, zyra e OSBE-së në

Prizren, ka implementuar një seri të seminaryve lidhur me ‘Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Femrës - (KEFDF), për komunitetin boshnjak dhe turk që jetojnë në Prizren dhe Prishtinë. Këto punëtori janë implementuar në bashkëpunim të ngushtë me organizatën ndërkombëtare turke ‘Anatolian Development Foundation’.

Juristët e njohur të këtyre komuniteteve, znj. Edija Sezairi dhe z. Iskender Muzbeg i kanë udhëhequr këto seminary. Ata kanë përdorur një çasje të përbashkët gjatë këtyre sesioneve duke u munduar ta sqarojnë ‘Konventën Ndërkombëtare mbi Diskriminimin’ me përdorimin e shembujve nga jeta e përditshme që ndikojnë në këto komunitete. Zoti. Arif Haliti përfaqësuesi i ‘Asociacionit të Mësuesve Boshnjak’ tha, “shkakëtarët kryesor se pse gruaja Boshnjake është e diskriminuar janë tradita, situata ekonomike dhe qeverisja joefikase.” Në këtë rast ai përmendi shembujt konkret se si kushtet jetësore ndikojnë në çështjet gjinore brenda komunitetit Boshnjak dhe në këtë

kontekst ai krahasoi situatën në Reqan me atë të fshatërave më të largët të Luginës së Zhupës.

Një rol më aktiv

Një gjë pozitive e dalur nga këto sesione ka qenë idea për formimin e një OJQ-je boshnjake në Prizren, e cila si organizatë do të punojë për promovimin e barazisë gjinore. Njëra ndër pjesëmarrësit në këto sesione ka qenë edhe përfaqësuesja e asambles komunale të Prizrenit. Edhe ky ishte një rast shumë i mirë që pjesëmarrësit ta inkurajojnë atë për një punë dhe rol më aktiv në këtë fushë.

Sesionet në temën e diskriminimit janë organizuar edhe me përfaqësueset e shoqatës së gruas turke ‘Hanim Eli’ nga Prishtina. “Është me rëndësi të madhe që të mbahen sesione me këtë temë edhe me përfaqësueset e komunitetit Turq që jetojnë në komunat që nuk janë përfshirë në këtë projekt,” ka sugjeruar Zonj. Lirije Gas. Ajo poashtu shtoi, “duke patur parasysh që në komizën kushtetuese thuhet që ky dokument është pjesë integrale e legjisllacionit të aplikueshëm në Kosovë, është me rëndësi për komunitetin e gjërë që të ketë njohuri mbi përmbajtjen e tij.”

Bashkimi i komuniteteve përmes buletinit të rinisë

Krijimi i një rrjeti në mes komuniteteve të ndryshme në Kosovë është çështje vendimtar për zhvillimin e shoqërisë civile.

Nga Patrik Hofman

Olga, Esma dhe Violeta vijnë nga komunitete të ndryshme etnike. Olga është kroate e Kosovës, Esma i përket komunitetit Rom dhe Violeta pjestare e komunitetit serb të Kosovës. Ato të gjitha flasin gjuhë të ndryshme, madje edhe në shtëpi. Përveq kësaj, ato janë koordinatore të buletinit të rinisë, projekt i dizajnuar nga departamenti për demokratizim i OSBE në komunën e Lipjanit. Kjo është ajo që ato kanë të përbashkët.

Gjatë mbledhjeve të tyre javore kuptuan se ato ndajnë shumë më tepër interesa të përbashkëta. Të gjitha dëshirojnë të përgatisin ushqim tradicional. Atyre i'u interesojnë revistat e modës dhe të gjitha e dojnë Kosovën ashtu si është. "Ka shumë interesa të përbashkëta që ne nuk jemi të interesuara të shpenzojmë kohën duke luftuar kundër njëra tjetrës siq e shohim këtë çdo ditë në politikë," thotë Violeta. Pra, ky është njëri nga qëllimet e këtij buletini, "është jo-politik dhe i bashkon të tri komunitetet të ndryshme brenda komunës së Lipjanit," sqaron Esma.



Olga, Esma dhe Violeta, koordinatore të revistës për të rinjë në Lipjan

Krijimi i rrjetve është një pikë-pamje e zhvillimit të shoqërisë civile, në veqanti kur ka të bëjë me bashkimin e komu-

niteteve kroate, serbe, dhe rome të Kosovës në komunën e Lipjanit. Me Krijimi i rrjetve dhe shpërndarjen e informacioneve,

komunitetet e izoluar janë në gjendje të afirmojnë identitetin e tyre kulturor dhe t'i ndajnë brengat e tyre ditore. Duke e

ruajtur identitetin e tyre kulturor, në një dialog më të gjerë dhe duke ndërtuar ura për shumicën, do të jetë kusht për tri komunitetet që të mbijetojnë si minoritete në Lipjan.

Duke i shprehur idetë në mënyrë plurale në pajtim me parimet bazë të demokracisë, komuniteti pakicë gëzon një nga të drejtat më themelore, të drejtën e të shprehurit "në buletinin, ne bisedojmë për jetën tonë në fshat, aktivitete të cilat ndërmerren, edhe në pjesët tjera të Kosovës por të nisura në komunën e Lipjanit" shton Olga me krenari.

"Qëndrimi i tri komuniteteve në komunën e Lipjanit varet shumë nga aftësitë e tyre për të afirmuar identitetin e vet përmes mediave dhe t'i shprehin mendimet e tyre lirshëm mbi çështjet e shoqërisë civile" thot Berat Reçica, asistent i demokratizimit për përkrhaje të projektit.

Buletini do të botohet në tri gjuhë dhe është i pari i këtij lloji në Kosovë.

Një dritare e hapur drejt botës

Kryetari i komunës së Zubin Potokut mirëpret hapjen e qendrës së re të komunitetit

Nga Mustafa Skenderi

"Ky institucion, të cilin e kemi themeluar ne, do të ndihmojë në forcimin e punës së shoqërisë civile, ndjenjën e punës së përbashkët si dhe në ndërtimin e një Kosove shumëetnike. Tani OSBE-ja do të qëndroj anash dhe do ta lerë këtë institucion në duart e vendorëve." Këto ishin fjalët e shefit të misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadorit Paskal Fieski me rastin e hapjes së qendrës së re të komunitetit në Zubin Potok.

Hapja e qendrës është shembull tipik se çka mund të bëhet për komunitetin, aq më tepër kur vendorët dhe ndërkombëtarët besojnë në të. Ky është rezultat i bashkëpunimit të mirë në mes të autoriteteve komunale, OSBE-së dhe OJQ-së vendore "Qendra për Bashkëpunim dhe Demokratizim" nga Zubin Potoku.

Kryetari i komunës së Zubin Potokut, Zoran Djuroviq ishte prezent gjatë ceremonisë së hapjes së qendrës. "Rruga për të krijuar këtë qendër nuk ka qenë e lehtë dhe as e thjeshtë," tha ai. "Por, ideja udhëzuese që ne kemi pasur, na ka mundësuar të ndërto-

jmë atë që kemi sot pa shumë përpjekje dhe lodhje."

Pas programit kulturor, përgaditur nga anëtarët më të

rinjë të grupit folklorit vendor "Mokra Gora" letra falendërimi i'u dhanë të gjithë pjesëmarrësve të cilët kishin

ndihmuar në çfarëdo mënyre për ndërtimin e qendrës së re të komunitetit. Në fund, ambasadori Fieski edhe zyr-

tarisht bëri hapjen e qendrës dhe tha se puna mund të fillojë.

Znj. Slavka Milosavljeviq, drejtore e qendrës së komunitetit dhe kryetare e OJQ-së

"Qendra për Bashkëpunim dhe Demokratizim" nuk hezitoi të shfaqë entuziazmin e saj për qendrën e re të komunitetit dhe mundësitë që ajo ofron.

"Kemi mund vetëm ta ëndërojmë këtë mirësi," tha Znj. Milosavljeviq. "Kjo qendër ka hapur një dritare drejt botës. Mendoj se me qasjen në internet që do ta kemi në këtë qendër, të rinjtë dhe studentët tanë do të kenë mundësi të komunikojnë me botën. Kjo ndërtesë është e hapur për të gjithë banorët e Zubin Potokut dhe rrethinës."

Përveq kësaj, qendra e re e komunitetit do të organizojë edhe orë për mësimin e gjuhës angleze dhe kurse të kompjuterëve. Vendorët do të marrin përsipër udhëheqjen e kësaj qendre kah fundi i këtij viti, si pjesë e procesit të transferimit, ku të gjitha qendrave e komuniteteve në Kosovë do të mbikëqyrjen nga vendorët.



Ambasadori Paskal Fieski në ceremoninë e hapjes së qendrës së komunitetit në Zubin Potok

Gazetarët që raportojnë për punën e Kuvendit të Kosovës në Slloveni

Nga Lizabeta Palokaj

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka organizuar një vizitë pune në Slloveni për gazetarët e mediave të shkruara dhe elektronike si pjesë e përpjekjeve të saj për përfundimin e punës së Kuvendit të Kosovës dhe mediave. Dy gazetarë nga 'RTK'-ja dhe 'Bota Sot', kryeredaktori i 'RTK' dhe përfaqësuesi i zyrës për trajnimin e mediave pranë OSBE-së ishin pjesëmarrës të kësaj vizite.

Në fillim të tetorit, grupi kishte përdituar një emision 25 minutësh për punën e Kuvendit të Kosovës nën udhëheqjen e Zonsh. Ljerka Bizilj. Ajo zbuloi se mbulimi i ngjarjeve ishte i politizuar dhe subjektiv, kishte paraqitur jo të barabarta të opinioneve të të gjithë spektrit të partive politike, si dhe kishte gazetarë të papërvuajë që mbulonin ngjarjet e Kuvendit. "Ekipit me të cilin kam punuar, i përbërë nga gazetarë të mediave të shkruara dhe elektronike, i mungon ndjenja e punës ekipe. Ata poashtu nuk kanë njohuri të përgjithshme se si raportohet për çështje të ngjashme në vende tjera," tha Zonsh. Bizilj.

Gjatë kësaj vizite, grupi i Kosovës është takuar me drejtorin

e përgjithshëm dhe zëvendës drejtorin e 'RTV Sllovenisë' për marrëdhënie ndërkombëtare, i cili është edhe anëtarë i bordit të RTK-së. Ky ishte një rast i mirë për ekipin e Kosovës të shkëmbejë përvoja dhe ide me ekspertët e Televizionit të Sllovenisë dhe të kërkojë mundësi për bashkëpunim. Pala sllovene ka shfaqur gadishmëri të ndihmojë gazetarët e Kosovës me trajnime të gazetarisë dhe shkëmbim të përvojave.

Gazetarët nga Kosova kanë vizituar gjithashtu Kuvendin e Sllovenisë ku janë njoftuar me sistemin kompjuterik 'Lotus Notes' i cili lidh kuvendin me rreth 400 gazetarë të akredituar slloven të mediave të shkruara dhe elektronike. "Ky program i mundëson Zyrës për informim të kuvendit nacional Slloven që automatikisht të ketë në intranet raportet, ngjarjet ose rezultatet nga secila mbledhje e kuvendit," shpjegoi Zonsh. Karmen Uglesic, zëvendës drejtueshë dhe departamenti për informim.

"Kemi marr shumë njohuri nga kjo përvojë për mënyrën e strukturimit të 'TV Sllovenisë', skemën programore dhe mënyrën se si organizohen deba-

tet në kuvend ose në qeveri," tha Idriz Morina, gazetar nga e përditshmeja 'Bota Sot'. "Jemi informuar për rolin e mediave sllovene në këto raste dhe pjesa më interesante për ne ka qenë njohja me mënyrën e funksionimit të zyrës për informim të kuvendit të Sllovenisë dhe programin 'Lotus Notes'. Ky është një mjet i fuqishëm që është në interes të mediave dhe opinionit publik, diçka që i mungon kuvendit dhe qeverisë tonë," deklaroi z. Morina.

Sipas Jelena Djurdjic nga 'RTK'-ja, qëllimet e vizitës kanë qenë njoftimi i mirë me mënyrën e funksionimit të Parlamentit slloven dhe mënyrën se si gazetarët raportojnë nga parlamenti, si dhe të shohim bashkëpunimin në mes të gazetarëve dhe zyrës për informim të parlamentit. "Kisha nderin të marr pjesë shkurtimisht në një nga seancat e parlamentit, por problemet me të cilat ballafaqohet parlamenti Slloven janë krejtësisht të ndryshme nga ato të cilat i preokupojnë anëtarët e Kuvendit të Kosovës," tha ajo.

Z. Zenë Sinanaj, gazetar i 'RTK'-së ishte i impresionuar. Një infrastrukturë e zhvilluar teknike është e vendosur në



Gazetarët vendor dhe anëtarët e OSBE-së të ekipit për zhvillimin e mediave, gjatë vizitës studimore në Slloveni

Sallën e Kuvendit, tha ai, e cila mundëson mbulim të drejtëpërdrejtë të punimeve të kuvendit deri në atë masë që kur një deputet merr fjalën, kamerat automatikisht fokusohen në folësin dhe fillojnë të incizojnë.

Ai shtoi se informatat që kuvendi dhe qeveria Sllovene i ofron mediave të shkruara dhe elektronike janë të shpejta dhe profesionale. Kjo iu mundëson gazetarëve slloven të kryejnë

punën e tyre në mënyrë profesionale dhe të informojnë publikun me kohë. "Do të ishte shumë mirë nëse metoda të ngjashme do të aplikoheshin në kuvendin e Kosovës. Objekti i kuvendit të Kosovës është duke u rindërtuar, kështu që presim t'i përmirësojmë edhe pajisjet e tyre teknike. Kjo do të ishte një ndihmë shumë e madhe për gazetarët të cilët mbulojnë seancat e Kuvendit," përfundoi Sinanaj.

Të rinjtë kundër dhunës në familje

Nga Haris Kurti

Zyra e OSBE-së në Mitrovicë kohën të fundit ka organizuar disa aktivitete të ndryshme me qëllim të shënimit të 25 Nëntorit, Ditës Ndërkombëtare për eliminimin e dhunës kundër femrave. Aktivitetet kishin për qëllim, trajnimin dhe ngritjen e vetëdijes për këtë ngjarje.

Shumice e anëtarëve të 'Klubit për të Drejtat e Njeriut' në Mitrovicë janë nxënës nga shkollat e mesme dhe janë të moshës 16 dhe 18 vjeqare. Sekcioni për avokim dhe mbrojtje

të viktimave të OSBE-së ka ofruar një sesion trajnimi të drejtore dhe në familje për nxënësit e 'Klubit për të Drejtat e Njeriut'. Dy nga trainuesit ishin anëtarë të stafit të departamentit për të drejta të njeriut të OSBE-së në Mitrovicë dhe i treti ishte Oficer i SHPK-së i cili kryen detyrën e koordinatorit rajonal për dhunë në familje.

Trajnimi i parë ishte i përqëndruar në definimin e dhunës në familje, ku adoleshentve u

ishte shpjeguar se dhunë nuk do të thotë vetëm kur viktimat rraheshin. Ata mësuan se xhelozia nga i dashuri apo ndjenja e tepruar e vëllezërve se janë pronarë të motrave gjithashtu janë shenja se ato mund të tregojnë dhunë në familje dhe paramesore. Sesioni i dytë është përqëndruar në aspektet ligjore. Oficeri i SHPK-së i cili e drejtoi këtë pjesë të trajnimit shpjegoi dispozitat e parapara me Rregulloren për mbrojtjen nga dhuna në Familje, duke potencuar të drejtat e viktimave, mbrojtjen e ofruar sipas ligjit dhe se çfarë do të thotë kjo për të pamarturit dhe familjarët.

Gjatë sesionit të tretë nxënësit janë informuar për shërbimet ekzistuese në dispozicion për të ndihmuar dhe mbështetur viktimat, si dhe të rehabilitohen kryesisht e veprës së dhunës familjare. Kjo iu bë e qartë nxënësve se anëtarët violent të familjeve gjithashtu kanë nevojë për ndihmë në të përballuarit me problemet e tyre.

Një 17 vjeqare e cili merrte pjesë në trajnim tha: "Trajnimi ishte mjaft i dobishëm. Përpara, shoqet dhe unë kemi pasur probleme me djem, por tash ne e dimë si të themi 'JO', dhe ata



Një i ri me shpërblime fituar për vizatimin më të mirë

të kuptojnë!" Në fund të trajnimit, nga pjesëmarrësit u kërkuar që të bëjnë vizatime si mënyrë e të shprehurit të ndjenjave të tyre për çështjet e diskutuara gjatë trajnimit. Në fund të trajnimit vizatimet u vendosën në një ekspozitë në sallën e komunës në Mitrovicë. Hapja e ekspozitës ishte përcjellur me ceremoni të vogël të inaugurimit

ku Ganimete Hasani, zyrtare komunale për çështje gjinore, u shpërndau disa dhurata të vogla nxënësve. Ekspozita zgjati prej 24 nëntor deri më 10 dhejtor, Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Aktivistët e 'Klubit për të Drejtat e Njeriut' gjithashtu morën pjesë në shpërndarjen e posterëve për ngritje të vetëdijes në qytetin e Mitrovicës.



Pikturat e ekspozuara në sallën e kuvendit komunal në Mitrovicë, të bëra nga të rinjtë pjesëmarrës në trajnimin kundër dhunës në familje dhe asaj paramesore

Rritja e reagimit të policisë ndaj dhunës familjare

'Aktiviteti për ndalimin e dhunës ndaj femrës' nuk është vetëm shpërndarja e informatave në opinion, gjithashtu ka të bëjë me përmirësimin e mundësive që policia apo autoritetet përkatëse të mirren me këtë çështje më seriozisht.

Nga Hana Kranston

16 ditë të aktivitetit

Gjatë fushatës së OSBE-së mbi dhunën në familje e cila u zhvillua në periudhën "16 ditët e aktivizimit", prej 25 nëntor deri më 10 dhjetor. Zyra e OSBE-së për përkrahje dhe mbrojtje të viktimave në Prishtinë nxori një projekt të quajtur 'Rritja e reagimit të policisë ndaj dhunës në familje'.

Projekti përfshiu trajnimin e pjestarëve të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK-së) mbi Regulloren e re të UNMIKU-t 2003/12 "mbi mbrojtjen kundër dhunës familjare". Në këtë projekt ishin përfshirë OSBE, Njësia policore mbi dhunën në familje dhe Koordinatori regional mbi dhunën në familje.

Trajnimi informoi pjestarët e policisë mbi obligimet e tyre nën Regulloren e re mbi dhunën familjare, për të ofruar ndihmën e tyre në këtë fushë dhe për të përmirësuar efektshmërinë e tyre në zbatimin e ligjit të ri.

Broshura xhepi

Projekti filloi më 24 nëntor në Stacionin e policor të Lipjanit ku të gjithë pjesëmarrësit morën broshura të vogla 110-fletëshe me



Oficerët e SHPK-së gjatë një trajnimit në Lipjan, njohtohen me rolin e tyre për dhunën në familje

fletëza të vogla ku ishin të shkruara dispozitat kyçe nga Regullorja mbi dhunën familjare. Zyrtarët e SHPK-së dhe UNMIK-ut morrën nga një broshura dhe u njoftuan për 30 minuta me përmbajtjen dhe përgjegjësitë e zyrtarëve nën rregulloren e re. Shpresohet se zyrtarët e SHPK-së do të mbajnë këto broshura me vete, dhe mund t'i referohen atyre nëse e kërkon nevoja.

Pas Lipjanit projekti vazhdoi dhe trajnimi u mbajt në Stacionin qendror policor të Prishtinës, në stacionin e Obiliqit, në stacionin e Fushë Kosovës dhe në stacionin

e Gllgovcivit ku u shpërndanë broshura xhepi gjithashtu. Stacionet e mbetura në regionin e Prishtinës do të marrin njoftohen me kohë dhe do t'u shpërndahen broshurat para përfundimit të vitit 2003. Ky aktivitet do të shtrihet në tërë Kosovë në janar dhe shkurt të vitit 2004.

Trajnimi ishte veçanërisht i dobishëm, duke pasur parasysh se institucionet vendore ashtu edhe individët përftuan shumë njohuri për ligjin dhe të drejtat e tyre dhe se si çështjet si dhuna në familje dhe trafikimi me njerëz mund të luftohen me sukses.

Rrjedha e informimit dhe institucionet

Në botën perëndimore, institucionet publike e kuptojnë se shkëmbimi i duhur e informatave është i rëndësishëm për vendosjen e raportve të mira ndërmjet institucioneve, duke përfshirë zyrtarët e zgjedhur apo të emëruar dhe qytetarët të cilëve u shërbejnë.

Nga Bernard Urban

Informimi është gjithnjë "rrugë me dy kahje". Fatkeqësisht, Kosova ka një trashëgim të ish-Jugosllavisë ku qeveria dhe organet e saj i thonin opinionit publik vetëm atë që qeveritarët mendonin se është e domosdoshme. Kjo mund të shihet në "themelet" filozofike mbi të cilat bazohej ligji për informim i Jugosllavisë.

Vizita në Sarajevë dhe Mostar

Sot, bashkësia ndërkombëtare dhe partnerët e saj në Kosovë mundohen të krijojnë institucione më të hapura dhe transparente. Prania e OSBE-së në terren i lejon asaj të punojë në

duke përfshirë edhe kryetarin e komunës, përshkruan në detaje mënyrën si kanë vepruar në lidhje me përgjegjësitë që dalin nga liria e qasjes në 'Ligjin për Informim'. (Si rezultat i këtij ligji, institucionet publike të Bosnjes dhe Hercegovinës duhet të jenë shumë më të përgjegjshme. Cilido qytetar mund të kërkojë informata të ndryshme nga komuna në të cilat institucioni duhet të përgjigjet brenda kohës së caktuar sipas ligjit, apo të ballafaqohet me pasojat). Ky ligj, i cili u hartua me ndihmën e Misionit të OSBE-së në Bosnje e Hercegovinë, i'u prezentua zyrtarëve lokal këtu në Kosovë me shumë pak ndryshime.



Panorë e Sarajevës

mënyrë të drejtëpërdrejtë me partnerët lokalë komunalë në drejtim të këtij qëllimi. Duke pasur këtë qëllim, departamenti i OSBE-së për demokratizim organizoi një vizitë studimore prej 19-22 tetor për Zyrtarët Komunalë për Informim (ZKI), të njohur si zëdhënës apo zyrtarë të mediave, nga Kosova për në Bosnje e Hercegovinë. Kjo kishte për qëllim gjithashtu shkëmbimin e përvojave me homologët e tyre nga qyteti i Mostarit dhe nga komuna e Qendrës së Sarajevës. Fillimisht ishin zgjedhur pesë pjesëmarrës nga komunat e Prishtinës, Pejës, Prizrenit, Gjilinit dhe Leposaviqit.

Liria e qasjes në Ligjin për Informim

Delegacioni i Kosovës u takua me homologët e tyre nga qyteti i Mostarit dhe Qendra e Sarajevës. Në çdo komunë është kaluar nga një ditë. Diskutimet ishin të përqëndruara në punën që bënin Zyrtarët Komunalë për Informim dhe në disa vështirësi që ata i hasin gjatë punës. U diskutuan mjetet për informim si faqet e internetit, konferencat për shtyp dhe paraqitjet në media si dhe marrëdhëniet në vetë strukturat komunale. Përvoja e Qendrës së Sarajevës ishte posaçërisht pozitive për faktin se përfaqësuesit komunal të saj,

Ndërtimi i marrëdhënies së re

Zyrtarët Komunalë për Informim, pjesëmarrës në këtë vizitë, do t'i ftojnë kolegët e tyre në një raport të shkurtër informativ kështuqë ata të mund të përcjellin diçka nga ajo që kanë parë dhe dëgjuar në Bosnje e Hercegovinë. Ata gjithashtu do ta diskutojnë udhëtimin me gazetarë lokal, duke vërtetuar se ata e kuptojnë rëndësinë e mbajtjes së raporteve të mira me media.

Edhe në të ardhmen do të vazhdojnë vizitat me Zyrtarët Komunalë për Informim të komunave të tjera të Kosovës të cilët merren me media periodikisht. Është kërkuar nga Zyrtarët Komunalë për Informim të informojnë OSBE-në se si të ndihmohen ata më së miri në përmirësimin e detyrave të përditshme. Një nga planet eksperimentale është që të ftohet zyrtarët e OSBE-së për t'i diskutuar pikat si teknikat intervistuese, 'forma të marketingut' dhe disajnimin të faqes së internetit.

Së bashku me partnerët lokalë, OSBE-ja do të vazhdojë në ndërtimin e filozofisë së re në Kosovë në aspektin e raporteve ndërmjet institucioneve publike dhe vetë opinionit publik. Puna me Zyrtarët Komunalë për Informim është vetëm një mënyrë e vurjes së kësaj filozofie në veprim.

DHUNA NË FAMILJE NUK ËSHTË ÇËSHTJE PRIVATE E FAMILJES! TA THEJTMË HESHTJËN!

NDAL DHUNËS NDAJ FEMRAVE